

V E N D I M
Nr.2, datë 25.2.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar,	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i	'''
Veli Budo,	Anëtar i	'''
Franc Jakova,	Anëtar i	'''
Thimjo Kondi	Anëtar i	'''
Natasha Sheshi	Anëtar i	'''
Ylvi Myrtja,	Anëtar i	'''
Hilmi Dakli,	Anëtar i	'''

me sekretare Drita Filto më datën 10.2.1994, 17.2.1994 dhe 25.2.1994 shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti, që i përket:

KËRKUES: GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, i përfaqësuar nga kryetar, Namik Dokle.

O B J E K T I:

Kërkohet interpretimi nëse është antikushtetuese thirrja e Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin Popullor për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste i është drejtuar kësaj Gjykate për arsye se kërkesa e këtij Grupi drejtuar Kryesisë së Kuvendit Popullor që të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm të paraqitet në Kuvend për t'iu përgjigjur disa pyetjeve të deputetëve në përputhje me nenin 82 të Rregullores së Kuvendit, nuk është realizuar për shkak se ky i fundit thirrjen e tij e ka konsideruar se vjen në kundërshtim me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Gjykata Kushtetuese me Vendimin e saj Nr.12, datë 28.10.1992, ka pranuar se Kuvendi Popullor duke patur të drejtën të kontrollojë veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm që parashikohet me dispozitë të shprehur kushtetuese (neni 16 pika 10 e Ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese") ka edhe të drejtën e marrjes së masave deri në largimin e tij nga detyra. Në atë vendim nuk kanë qenë objekt shqyrtimi format e atij kontrolli. Një nga mënyrat e ushtrimit të kontrollit është edhe pyetja e Prokurorit të Përgjithshëm në seancë plenare në lidhje me aspekte të veprimtarisë së tij, e parashikuar në nenin 82 të Rregullores së Kuvendit Popullor. Pretendimi i ngritur prej tij se paraqitja vjen në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit Nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", që parashikon pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe nenit 13 të atij ligji që parashikon se Prokuroria organizohet e funksionon brenda sistemit gjyqësor nuk qëndron. Kjo për faktin se sipas nenit 5 të të njëjtit ligj, Prokuroria nuk përfshihet në pushtetin gjyqësor, por vetëm se organizohet e funksionon brenda atij pushteti si organ unik dhe i centralizuar dmth., që ka varësi hierarkike.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 1 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 duke bërë interpretimin e dispozitave kushtetuese të mësipërme, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Thirrja e Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvendin Popullor, për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve është në pajtim me Ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.